

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                           |
|---------|---------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn                                  |
| ADRESA  | https://boldnews.al/2026/09/15/gjykata-e-larte-le-ne-burg-erion-veliaj-2/ |
| BURIMI  | boldnews.al                                                               |
| GJENDJA | edited                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 15 shtator 2026, 09:10:31 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 09:09:16 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | a31f054a51763ac9c36c41e5ae14289cd28660c8814b05ea174743ea56fa66b9 |
| TEKSTI     | 5de1b97af8ce7b4bd943e8876c4eccc21ae961f38bba29ddb4e2d644c7d9a91a |
| PAMJA      | da349b8191f47e0cd0b22ada409e0d6058b309aec32a6aab72640b7d0d054320 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | e583cdb621f8b6808c3b66c2aaec9044368f29fd802716ca4f9781b223a263fc                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | 3f1c762bd262f20b11edfa4cdbe13fc1fb6ba01c720372698e79eb79fc11d19c                                                                                                   |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/e583cdb621f8b6808c3b66c2aaec9044368f29fd802716ca4f9781b223a263fc

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Fillimi &gt; AKTUALITET

## Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn

11:09 : 15/09/2026 në AKTUALITET, KRYESORE, POLITIKE



Gjykata e Lartë ka rrëzuar rekursin e kryebashkiakut të Tiranës Erion Veliaj dhe ka lënë në fuqi vendimin “arrest me burg”.

Çështja u shqyrtua në Dhomë Këshillimi nga Kolegji Penal, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila i kërkoi Gjykatës së Lartë të arsyetonte pretendimet e Veliajt për joproporcionalitetin e masës së sigurisë.

Kolegji Penal la në fuqi vendimin e 13 marsit 2025 të Apelit të Posaçëm, i cili kishte konfirmuar masën e ‘arrestit në burg’ të dhënë ndaj Veliajt nga GJKKO.

Gjykata e Lartë ka 60 ditë afat për të zbardhur vendimin, ku pritet të argumentojë edhe përse në rastin e Veliajt nuk është e përshtatshme një masë më e lehtë sigurie.

Lexo edhe:

[Pasi mbeti në burg, a duhet të dorëhiqet Veliaj?](#)

[Apeli i GJKKO lë në burg Ilir Metën](#)

“Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i mbledhur në datë 15 shtator 2026, në Dhomë Këshillimi, mori në shqyrtim dosjen penale me palë: Kërkues: Erion Veliaj, Palë e Interesuar: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe objekt: Shfuqizimin e vendimeve nr. 7, dt. 09.02.2025, te Gjykatës se Posaçme te Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlefteuar permes vendimit nr. 14, dt. 12.02.2025, te Gjykatës se Posaçme te Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 13, dt. 13.03.2025, te Gjykatës se Posaçme te Apelit per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1153 (176), dt. 08.07.2025, te Kolegjit Penal te Gjykatës se Lartë. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te subjektit te interesuar.

Pasi shqyrtoi çështjen, Kolegji, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e” të Kodit të Procedurës Penale, vendosi: Lënien në fuqi të Vendimit nr.13 (87-2025-85), datë 13.03.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.” – thuhet në vendim.

Më herë Gjykata e Lartë në tetor 2025 dhe maj 2026, ka vendosur se Erion Veliaj duhet të

### TË GJITHA



**Pasi mbeti në burg, a duhet të dorëhiqet Veliaj?**

12:48 : 15/09/2026



**Apeli i GJKKO lë në burg Ilir Metën**

12:26 : 15/09/2026



**Rrezik lufte në lindje të Evropës! Fregata ruse lëshon dy raketa ndaj helikopterit danez**

12:26 : 15/09/2026



**Milano në mbështetje të protestave në Tiranë, shqiptarët thirrje për marshim masiv më 20 shtator**

12:17 : 15/09/2026



**Gjykata e Lartë la Veliajn në burg/ Tabaku: Rama bashkëpërgjegjës për korrupsionin në Tiranë**

12:13 : 15/09/2026



**Çmimet e larta nuk frenojnë kërkesën, rriten shitjet e karburanteve**

12:08 : 15/09/2026



**Arrestohet në Belgjikë Jasin Avdyli, SPAK e akuzon për trafik droge dhe grup të strukturuar kriminal**

11:58 : 15/09/2026

me hetet, Gjykata e Lartë, në tetor 2025 dhe maj 2026, ka vendosur se Erion Veliaj duhet të qëndrojë në paraburgim, pasi mund të tjetërsojë provat e faktet dhe mund të përdorë pushtetin e tij për të ushtruar ndikim mbi dëshmitarët.

Gjykata Kushtetuese, e investuar nga avokatët e Veliaj, vendosi në Korrik 2026 që çështja e masës së sigurimit ndaj tij duhet të rishqyrtohej në Gjykatën e Lartë.

Në vendimin që ndau gjyqtarët kushtetuese, shumica prej tyre dha qëndrimin se “Gjykata e Lartë nuk kishte respektuar standardin kushtetues për arsyetimin e plotë të vendimit”.

Për gjyqtarët kushtetues, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kishte ezaruar të gjithë argumentat se përse Veliaj duhet të qëndronte në paraburgim. Një çështje teknikalitetesh procedurale, të cilat tashmë u rimerën sërish në shqyrtim nga gjyqtarët e lartë.

Kujtojmë se Erion Veliaj ndodhet në qeli prej shkurtit të 2025-ës dhe ndaj tij ka nisur gjyqi i themelit. SPAK e akuzon Veliajn për 13 akuza, të tilla si korrupsion pasiv, pastrim parash, mosdeklarim pasurie, shpërdorim detyre dhe futja e sendeve në burg, por kryebashkiaku i ka mohuar.

Tashmë, mbrojtja e Veliajt pritet që të dërgojë dosjen në Strasburg, ndërsa kryebashkiaku po i firmos vendimet nga qelia pasi shkarkoi kryetaren e komanduar, Anuela Ristani.

Etiketa: Burg Erion Veliaj Gjykata e larte

Lajme të lidhura



Pasi mbeti në burg, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

12:48 : 15/09/2026



Apeli i GJKKO lë në burg Ilir Metën

12:26 : 15/09/2026



Gjykata e Lartë la Veliajn në burg/ Tabaku: Rama bashkëpërgjegjës për korrupsionin në Tiranë

12:13 : 15/09/2026



I njohur për famën e arratisjeve nga burgjet greke, si mori 16 ditë leje Alket Rizai

10:31 : 15/09/2026



Erion Veliaj kërkon lirimin nga burgju, Gjykata e Lartë shqyrton sot masën e sigurisë

08:59 : 15/09/2026



Seanca në Gjykatën e Lartë/ Nuk gjykohet kryebashkiaku, por individi Erion Veliaj, i akuzuar për korrupsion

21:12 : 14/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

f i y